

Bedri MUHADRI

LUFTA ÇLIRIMTARE E ARBËRVE NË KOHËN E SKËNDERBEUT

Gjergj Kastrioti-Skënderbeu, djali i princit arbëror Gjon Kastrioti, i shkolluar për artin ushtarak në pallatin ushtarak të sulltanit, shumë shpejt u bë gjeneral i shquar, dhe mori titullin sanxhakbej në kudër të administratës osmane. Në vitin 1443, Skënderbeu sipas planit të bërë me shumë princër tjerë arbërorë, iku nga kampi ushtarak osman me rastin e betejës së Maricës afër Nishit në vitin 1443, dhe bashkë me shumë ushtarë tjerë arbërorë kthehet në Arbëri. Më 2 mars, Skënderbeu mblodhi tërë princat arbërorë në Kuvendin e Lezhës, dhe formoi frontin e gjerë të përbashkët për luftë çlirimtare kundër osmanëve. Skënderbeu u zgjodh udhëheqësi i Lidhjes Arbëror. Ai ndërmoi masa organizative ushtarake e ekonomike në përgatitjet për rezistencë luftarake ndaj agresionit të mundshëm osman. Ushtria arbërore dhe i tërë populli arbëror u bashkua rreth autoritetit të Skënderbeut. Rezistenca arbërore e kohës së Skënderbeut arriti që me shumë suksese të bëjë ballë sulmeve të vazhdueshme osmane. Qendra e rezistencës arbërore ishte Kruja, e cila u mbrojt me suksese përballë tri sulmeve osmane (1450, 1466, 1467) me ushtri shumë të madhe e më mjete luftarake të shumta. Rezistenca arbërore e kohës së Skënderbeut arriti që për 25 vjet të jetë fitimtare në beteja të drejtpërdrejta me ushtrinë osmane. Rezultatet e rezistencës arbërore të kohës së Skënderbeut ishin të mëdha. U çlirua vendi, u bashkuan princërit arbërorë dhe u formua shteti feudal mesjetar arbëror në një pjesë të territoreve të veta.

Lufta çlirimtare shqiptare në kohën e Skënderbeut shënon faqe të ndritshme të historisë së popullit shqiptar në mesjetë. Ajo kishte rëndësi të brendshme dhe ndërkombëtare, udhëheqësi i saj u bë personalitet ndërkombëtar. Lufta çlirimtare shqiptare nën udhëheqjen e Skënderbeut, u bëri ballë pushtuesve të huaj osmanë e venedikas.

Lufta shqiptare e kohës së Skënderbeut ndahet në tri faza:

-Faza e parë nga vitet 1443 - 1450;

-Faza e dytë nga vitet 145 - 1461;

-Faza e tretë në vitet 1462 - 1468.¹

¹ Flamur Hadri, “Rëndësia historike e Lëvizjes Çlirimtare në epokën e Gjergj Kastriotit-Skënderbeut”, Simpoziumi për Skënderbeun, (Prishtinë: Instituti albanologjik, 1969), 10.

Faza e parë e rezistencës çlirimtare

Skënderbeu në një moment të rëndësishëm zgjodhi të braktisë autoritetin e vet sundues në kuadër të administratës osmane.² Ky momenti ndodhi në vitin 1443 në betejën e Maricës në Nish, ndërmjet ushtrisë osmane në të cilën Skënderbeu ishte pjesë e asaj³ dhe ushtrisë hungareze. Më 3 nëntor 1443, hungarezët të udhëhequr nga Janosh Huniadi, vojvoda i Transilvanisë, kaluan lumin Danub dhe sulmuan ushtrinë osmane që qëndronte në bregun tjetër të Moravës në afërsi të Nishit. Ushtria hungareze korri suksese duke e shpartalluar ushtrinë osmane. Thyerja e ushtrisë osmane i dha rast Skënderbeut ta vinte në zbatim planin e tij të përgatitur prej kohësh.⁴ Së bashku me 300 kalorës arbërorë të repartit të tij, dhe i shoqëruar nga vëllai, Stanishi dhe nga Hamza Kastrioti, ai e braktisi frontin e luftimeve dhe kampin osman dhe u nisë me shpejtësi në drejtim të Dibrës.⁵ Gjatë kthimit Skënderbeu me 300 luftëtarë pas shtatë ditë rrugëtimiti kah Fushë-Kosova, Prishtina, Prizreni, që ishte e lirë nga osmanët dhe më tej zbriti në Dibër.⁶

Qëllimi fillestar ishte të merrej qyteti i Krujës bashkë me kalanë e saj. Skënderbeu kishte dërguar forca ushtarake për t'u fshehur në pyjet dhe grykat afër Krujës derisa ai të shtinte në dorë Krujën, pastaj do t'i fuste fshehurazi në kështjellë për të shtypur rojën e osmanëve. Skënderbeu u paraqit pranë autoriteteve osmane të Krujës si i riemëruar në detyrën e subashit të saj, funksion që e kishte ushtruar në fund të viteve '30 të shek. XV.⁷ Pasi mori në

² Në vitin 1438 ndoshta dhe më parë, Skënderbeu ndodhej në Shqipëri me detyrën e qeveritarit (subashit) të vilajetit të Krujës, pasi i kishte vdekur i ati, Gjoni më 1437. Më 1440, Skënderbeu u largu nga Kruja dhe shkoi me detyrën e sanxhakbeut të sanxhakut të Nikopolit në Bullgari. *Gjergj Kastrioti Skënderbeu dhe lufta shqiptaro-turke e shekullit XV*, (Tiranë: Universiteti Shtetëror i Tiranës, Instituti i Historisë dhe i Gjuhës, 1967), 40.

³ Skënderbeu mori pjesë në formacione të ushtrisë osmane me kalorësit e vet spahij e xhebelij në frontin e Danubit, nën urdhëratë e Kasëm Pashës, bejlerbeut të Rumelisë. *Gjergj Kastrioti Skënderbeu dhe lufta shqiptaro-turke*, f. 42.

⁴ Atëherë Skënderbeu, që e i vërente të gjitha këto më vëmendje dhe ua kishte shfaqur që më parë planin miqve. Marin Barleti, *Historia e jetës dhe veprave të Skënderbeut*, (Prishtinë, 1982), 64.

⁵ Shumë ushtarë të fisit epirot që ishin pjesëmarrës në atë betejë, kur e kuptuan veprimin e radhës së Skënderbeut, ata u mblodhën rreth tij dhe formuan menjëherë një forcë ushtarake prej treqind frymësh. Barleti, *Historia e jetës dhe veprave*, 65.

⁶ *Histori e popullit shqiptar I, ilirët, mesjeta, Shqipëria nën Perandorinë Osmane gjatë shek. XVI - vitet '20 të shek. XIX*, (Tiranë: Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Historisë, 2002), 396.

⁷ Skënderbeu sipas planit arriti që nga sekretari i Sulltanit të merrte autorizimin në emër të Sulltan Muratit me anën të së cilës Skënderbeu bëhet sundimtari i ri i Krujës. Barleti, *Historia e jetës dhe veprave*, f. 65; *Historia e popullit shqiptar I, ilirët*, 399.

dorëzim Krujën, Skënderbe sipas të drejtës së luftës, vrau shumë veta që nuk u dorëzuan, por edhe la të lirë shumë qytetarë e ushtarët osmanë, pas dorëzimit të largoheshin nga Arbëria, duke përfshi edhe dizdarin e kështjellës, Ballaban Pashën, i cili pas dy dhjetëvjeçarësh do të vihet në krye të trupave osmane për të rimarrë Krujën.⁸

Më 28 nëntor të vitit 1443, Skënderbeu urdhëroi zëvendësimin e flamurit turk me flamurin me shqiponjën e zezë dykrenore, që ishte flamuri i Kastriotëve, i përshëndetur nga të gjithë, me thirrje të zjarra, “*Rroftë, rroftë, Princi ynë, i madhi Skenderbeg*”.⁹

Popullata arbërore shprehu gatishmëri të plotë për bashkim me princin e tyre. Këtë gatishmëri e shprehu edhe vetë Skënderbeu, i cili me rastin e çlirimit të Krujës më 28 nëntor, iu mbajti banorëve të Krujës një fjalim të zjarrtë e plotë patos politik. Këtë fjalim dhe rrjedhën e tërësishme të historisë arbërore të kohës së Skënderbeut e shkruan biografi më i shquar Marin Barleti me veprën: *Historia e jetës dhe veprave të Skënderbeut*. Sipas Barleti, Skënderbeu duke vlerësuar lart gatishmërinë e madhe të arbërve për të luftuar iu drejtua krutanëve me fjalët lapidare: “*Ju, epirotët, mund të gjenit një tjetër mbrojtës të lirisë, një tjetër përkryes të qëllimeve dhe aspiratave tuaja, sepse, në këtë vend, s’kanë munguar mendjet e ndritura...*”,¹⁰ “*... Ju, si burra aq të fortë, të rritur në liri, që qëndruat kaq kohë nën mynxyrën barbare, nuk u mërzitët derisa të më shihnit*”¹¹. Se vërtet Skënderbeu e vlerësoi gatishmërinë e popullatës arbërore për të luftuar për lirin e vendit e shprehu sipas Barlecit: “*Përse doni që unë të mbaj për vehte me të padrejtë emrin e çlirimtarit? Lirinë nuk u solla, por e gjeta unë këtu*”.¹²

Pasi mori Krujën, Skënderbeu u nis drejt në krahinat e Matit e të Dibrës, që bënin pjesë në zotërimet e Kastriotëve, ku i drejtoi popullsisë thirrjen që të ngriheshin kundër osmanëve.¹³ Në Dibër, Skënderbeu e gjeti popullsinë e gatshme për kryengritje të cilët ishin bashkuar rreth Hamza Kastriotit.¹⁴ Skënderbeu vendosi më se dy mijë luftëtarë në malin e Mokrës jo larg qytetit të Sfetigradit me qëllim që këta të mbyllnin rrugën e ikjes së sundimtarëve osmanë që ishin brenda vendit, si dhe të ruanin rrugët kryesore nëpër të cilat priteshin të ishin sulmuar nga ushtria osmane.¹⁵

⁸ *Historia e popullit shqiptar I, ilirët*, 399.

⁹ Dhimitër Frangu, *Veprat e lavdishme të Skënderbeut*, (Tiranë, 2005), f. 46, 47.

¹⁰ Barleti, *Historia e jetës*, 73.

¹¹ Po aty.

¹² Po aty.

¹³ *Gjergj Kastrioti Skënderbeu dhe lufta shqiptaro-turke*, 42.

¹⁴ Barleti, *Historia e jetës dhe veprave*, 70.

¹⁵ Po aty, 71.

Me forcat e armatosura që u grumbulluan me shpejtësi, Skënderbeu, duke përfituar nga përparimi i mëtejshëm i Huniadit, i cili po depëronte thellë në Gadishullin Ballkanik dhe kishte hyrë në Bullgari, shtiu në dorë njëren pas tjetrës, gjatë muajit dhjetor, kështjellat e Petrelës, Gurit të Bardhë, Stelushin dhe Tornaçat në Dibër.¹⁶ Luftëtarët e Skënderbeut ndërkohë kaluan në Dibrën e Sipërme, ku në bashkëveprim me trupat e Gjergj Arianitit e të Zahir Gropës çliruan qytetin e Ohrit dhe kështjellën e Sopotnicës (Sfetigradit), të ngritur në veriperëndim të Manastirit dhe që kishte një pozicion shumë strategjik për kontrollin e rrugëve që lidhnin Përlepin e Manastirin me rajonet në perëndim të tyre. Bashkë me Ohrin dhe Sopotnicën në duart e arbërve ranë edhe Struga, Kërçova, si dhe kështjella më të vogla që kontrollonin rrugët tregtare në hapësirat e Dibrës së Sipërme.¹⁷ Gjithashtu Skënderbeu në Jug të Shkupit mori për herë të parë në zotërim të Kastriotëve rajonin malor të Mokrës (malet Jakupice). Ai vuri nën kontroll rrugën e rëndësishme Shkup-Kërçovë, traseja e së cilës kalonte përgjatë luginës së lumit Treska.¹⁸ Në këtë kohë edhe viset tjera arbërore administroheshin nga fisnikët arbërorë.

Në Arbërinë e Epërme, kështjellën e Jeliçës (Jenipazarit-Pazarit të Ri) dhe atë të Zveçanit duhet t'i kenë marrë Spanët, kurse rajonin e Pejës Dukagjinët.¹⁹ Edhe Stefan Gjuraşi (Cërnojeviçi) me përkrahjen e Skënderbeut, zgjeroi kufijtë e zotërimeve të tij dhe si kryeqendër të tyre e bëri Zhabjakun.²⁰ Në hapësirat arbërore që u çliruan me kryengritjen e përgjithshme të vitit 1443 gjendeshin zotërimet e shumë fisnikëve arbërorë. Më të rëndësishmet prej tyre i përbënte shteti i Kastriotëve, që u ngrit shumë shpejt nën drejtimin e Skënderbeut. Ai gjendej në qendër të viseve të lira, shtrihej në vijën detare Lezhë-Durrës dhe arrinte në lindje deri në afërsi të Shkupit.²¹ Skënderbeu sipas planit të tij për bashkimin e princërve të Arbërisë, arriti t'i bindte krerët feudalë, të demoralizuar nga dështimet e mëparshme që t'i linin mënjanë mosmarrëveshjet midis tyre dhe të bashkoheshin në një front të vetëm luftarak kundër armikut të huaj. Ky bashkim i princërve arbërorë u arrit më 2 mars 1444, në Kuvendin e Lezhës. Mbledhja u caktua të mbahej në qytetin e Lezhës, që ishte nën zotërimin e Venedikut, për të evituar pakënaqësinë e princërve arbërorë, që mund të shkactohej në qoftë se mbledhja mbahej në pronat e njërit prej tyre. Në

¹⁶ Gjergj Kastrioti Skënderbeu dhe lufta shqiptaro-turke, f. 43.

¹⁷ Historia e popullit shqiptar I, ilirët, f. 400.

¹⁸ Po aty.

¹⁹ Po aty.

²⁰ Po aty.

²¹ Po aty.

kuvend morën pjesë bujarët më të shquar shqiptarë: Gjergj Arianiti, Nikollë e Pal Dukagjini, Theodor Korona Muzaka, Lekë Zaharia, Gjergj Stres Balsha, Pjetër Spani, Andrea Topia, Tanush Topia, Stefan Cërnojeviqi nga Mali i Zi, përfaqësues të bashkësive malësore dhe mjaft feudale të tjerë nga Arbëria Veriore dhe ajo Jugore.²²

Në Kuvend u ftuan edhe Republika e Venedikut dhe ajo e Raguzës. Këtu në këtë Kuvend historik u krijua Shqipëria feudale. Kuvendi shpalli Skënderbeun për kryetar të saj. U morë vendim që të formohet ushtria e përbashkët arbërore, e cila do të përbëhej nga repartet që do t'i rekrutonin si Skënderbeu ashtu edhe bujarët e tjerë në zotërimet e tyre. Komandant i parë i ushtrisë arbërore u zgjodh Skënderbeu, me titull “Kapiten i Përgjithshëm” (Capitaneus Generalis).²³ Në duart e Skënderbeut, i cili fitoi një prestigj dhe autoritet në masat e gjëra popullore si çlirimtar i vendit nga pushtuesit e huaj, Lidhja e Lezhës, u bë një mjet që shërbeu për bashkimin politik të mbarë popullit shqiptar në luftë kundër pushtuesve.

Në periudhën 1444-1450 Lidhja e Lezhës e udhëhequr nga Skënderbeu, korri suksese të shkëlqyeshme kundër ushtrisë osmane. Beteja e parë u zhvillua në fushën e Torviollit, më 29.06.1444. Sulltan Murati II dërgoi Ali Pashën me 25 000 veta për të shuar kryengritjen e arbërve. Ushtria osmane hyri në Arbëri nga lugina e Drinit të Zi. Skënderbeu informohet me kohë se ushtria osmane po depërtonte në drejtim të fushës së Torviollit, prandaj e ndau ushtrinë e tij në tri pjesë dhe manovroi duke futur në kurthe ushtrinë e Ali Pashës në territorin e rrethuar me bjeshkë e male në fushën e Torviollit duke e mundur ushtrinë osmane dhe ajo u detyrua që të tërhiqet. Osmanët lanë në fushën e betejës 7 mijë të vrarë dhe u zunë robër 500, kurse nga ushtria e arbërve ishin afërisht 3 800 të varë e të plagosur.²⁴ Osmanët iu drejtuan Arbërisë më 1445, por edhe këtë radhë osmanët u mundën më 10 tetor 1445 në fushën e Mokrës. Disfatë përballë rezistencës arbërore pësuan osmanët edhe në vitin 1446 në fushën e Otrantos në Dibrën e Sipërme.²⁵ Gjatë vitit 1447 nuk u zhvillua ndonjë luftë kundër ushtrisë osmane. Pikërisht atëherë në Arbëri shpërtheu anarkia feudale. Në këtë periudhë Lufta çlirimtare shqiptare u zhvillua si e suksesshme edhe kundër Republikës së Venedikut, e cila kishte shfrytëzuar situatën politike me qytetin e Danjës dhe arriti që ta zotëronte.

²² Fan S. Noli, *Gjergj Kastrioti Skënderbeu, 1405-1468*, (Tiranë: “Naim Frashëri”, 1967/1967), 84.

²³ *Gjergj Kastrioti Skënderbeu dhe lufta shqiptaro-turke*, 46.

²⁴ Flamur Hadri, *Gjergj Kastrioti-Skënderbeu dhe epoka e tij në historiografinë shqiptare*, (Prishtinë: Instituti Albanologjik, 1995), 89.

²⁵ *Historia e popullit shqiptar I*, (Prishtinë, 1967), 12.

Lidhja shqiptare doli hapur kundër aneksimit nga ana e Venedikut dhe pa mëdyshje hyri në luftë të drejtpërdrejtë. Në këtë luftë feudalët shqiptarë nuk qenë aq të bashkuar si më parë në luftëra kundër osmanëve. Një pjesë e feudalëve shqiptarë kaloi në anën e venedikaseve e një pjesë ishte neutrale dhe sigurisht se pjesa më e madhe e feudalëve dhe e popullatës ishte me Skënderbeun. Lufta e Danjës përfundoi me marrëveshjen e 8 tetorit 1448.

Marrëveshja nga ana e Skënderbeut ndërlihet edhe me situatën e krijuar me Betejën e Dytë të Kosovës, 1448.²⁶ Rezistencën e vet heroike shqiptarët e realizuan në vitin 1450 në mbrojtje të qytetit të Krujës. Ushtria osmane prej 100 mijë vetash, Sulltan Murati duke pasur me veti edhe birin e tij sulltanin e ardhshëm Mehmetin II, u nis në ditët e para të majit 1459 në drejtim të Shqipërisë me synim që përfundimisht të thuhet rezistenca shqiptare. Duke kaluar përmes Maqedonisë, ushtria osmane doli në Ohër dhe vazhdoi gjatë luginës së Shkumbinit, e arriti në Krujë. Kronisti bizantin, Laonik Halkokondili, shkruan: *pasi mblodhi të gjithë ushtritë e Azisë dhe të Evropës*.²⁷ Skënderbeu i lajmëruar me kohë për këtë ekspeditë të madhe, mori një sërë masash mbrojtëse. Epërsia e madhe e ushtrisë osmane, e bënë Skënderbeun të mos u dilte përpara ushtrisë osmane në luginën e Drinit e as në qafën e Thanës, por e la ushtrinë osmane të depëronte dhe të arrinin deri në muret e Krujës. Më 14 maj 1450 nën muret e Krujës arriti ushtria osmane. Skënderbeu brenda në Krujë kishte ushtrinë prej 1 500 ushtarësh nën komandën e Kontit Uran, një nga komandantët më të shquar. Skënderbeu me një ushtri prej 8 mijë vetash qëndroi jashtë mureve të Krujës.

Ndonëse iu premtuan shumë shpërblime e dhurata komandantit të Kalasë së Krujës, Kontit Uran, për të dorëzuar Kalanë, me vendosmëri ai dha përgjigje negative. Qyteti i Krujës bashkë me Kalanë u bombarduan fuqishëm nga artileria osmane. Skënderbeu në krye të 8 000 ushtarëve, si një lumë që vërshon siç e përshkruan Barleti, godiste ditë e natë ushtrinë osmane, ndërpriste rrugët e komunikacionit, shpartallonte detashmente ushtarake osmane.²⁸ Luftimet midis osmanëve dhe shqiptarëve vazhduan prej muajit maj deri më 26 tetor të vitit 1450. Osmanët u tërhoqën nga rrethimi i Kalasë së Krujës, duke pësuar dëme të mëdha në njerëz dhe në fuqinë e vet ushtarake. Nën muret e Krujës rezistenca shqiptare triumfoi me gjakun e derdhur të disa

²⁶ Më gjerësisht shih: Bedri Muhadri, "Skanderbeg's Activity During the Period of 1443-1448", *History Research Volume 9, Issue 1*, June 2021, Pages: 49-57; Bedri Muhadri, "Beteja e dytë e Kosovës, më 1448, sipas autorëve shqiptarë të kohës: Marin Barleti, Dhimitër Frangu", *Gjergj Kastrioti-Skënderbeu në 550-vjetorin e vdekjes*, (Prishtinë: Instituti i Historisë, 2019), 125-142.

²⁷ Fan S. Noli, *Gjergj Kastrioti Skënderbeu 1405-1468*, (Tiranë: "Naim Frashëri", 1967), 99.

²⁸ Noli, *Gjergj Kastrioti Skënderbeu, 1405-1468*, 99.

mija vetave të rënë heroikisht në luftë. Studiuesi Falmerajeri shkruan se: “*këtu mbaroi akti i parë i dramës tragjike të madhe shqiptare*”.²⁹

Pas këtij akti të dramës shqiptarët, Skënderbeu udhëheqësi i arbërve u bë autoriteti më i admiruar në politikën aktuale të kohës. Rezistenca shqiptare nën udhëheqjen e Skënderbeut ndikoi pozitivisht në integrimin e fisnikëve shqiptarë. Integrimi dhe forcimi i unionit të përbashkët u bë mundësia më e mirë për të ruajtur lirinë dhe pronat e tyre. Këtë bashkim e përshkruan Gjon Muzaka në Kronikën e tij, *Historia dhe gjenealogjia e shtëpisë së Muzakajve*, tregon se Skënderbeu shtiu në dorë shumë krahina të princërve arbërorë “.. *shkrija dhe aneksimi i zotërimeve të fisnikëve shqiptarë nga Skënderbeu ndodhte ngaqë ky pra (Skënderbeu) kishte në dorë ushtrinë për luftë, dhe kishin gjithnjë osmanët mbi krye...*”.³⁰ Skënderbeu filloi të merrte masa të rrepta kundër feudalëve të lëkundshëm, t’i hiqte nga postet që zinin oficerët e paaftë dhe t’i zëvendësonte me oficerë të rinj, të aftë dhe besnikë. Për më tepër, ai filloi t’i zhvishte kohë pas kohe bujarët e dyshimtë edhe nga zotërimet feudale të cilat ua shpërndau ushtarëve të dalluar. Me rritjen e vazhdueshme të pushtetit të Skënderbeut, kufijtë e mëparshëm të zotërimeve të princërve arbërorë u kthyen në kufij administrativë shtetërorë.

Kufijtë e mundshëm të shtetit mesjetar të Skënderbeut, në kulmin e lulëzimit të vet, shtriheshin në perëndim, me brigjet shqiptare të Adriatikut, që nga Velipoja deri në Seman, me përjashtim të qyteteve të Lezhës dhe të Durrësit, në lindje ato arrinin përtej Drinit të Zi, deri në malet e Korabit, të Kërçinit e të Strogovës, së bashku me grykën e Radikës, në veri ato kufizoheshin me zotërimet e Dukagjinëve, deri te Mati, e në jug deri në afërsi të qytetit të Beratit. Kryeqytet i shtetit të bashkuar u bë Kruja. Ky bashkim ishte i favorshëm për shumë feudale arbërorë, por disa princër, si Arianitët dhe Dukagjinët, mbetën edhe për një kohë të pavarur në zotërimet e veta.

Faza e dytë e rezistencës çlirimtare

Në vitin 1452 sulltan Mehemi II dërgoi dy ekspedita ushtarake osmane me qëllim që ta thyente rezistencën arbërore. Por të dyja këto ekspedita u thyen njëra pas tjetrës, më 21 korrik në afërsi të Modricës, ku u zu rob edhe komandanti osman Hamza Pasha, dhe e dyta pak më vonë në fushën e Meçadit, ku ushtria osmane u thye plotësisht, duke lënë të vrarë edhe komandantin e saj, Talip Pashën.³¹ Humbjet ishin të mëdha nga ana osmane

²⁹ Fan S. Noli, *Gjergj Kastrioti Skënderbeu, 1405-1468*, (Tiranë: “Mihal Duli”, 1967), 101.

³⁰ Gjon Muzaka, *Memorja*, (Tiranë: Toena), 50.

³¹ *Gjergj Kastrioti Skënderbeu dhe lufta shqiptaro-turke*, 70.

por edhe nga radhët e ushtrisë së arbërve pati shumë të vrarë.

Në prill 1453, përsëri një ushtri osmane nën komandën e Ibrahim beut, iu afrua Arbërisë, por edhe kjo u mund nga ushtria arbërore në betejën e zhvilluar më 22 prill, në fushën e Pollogut, midis Dibrës dhe Tetovës.³² Vitet që pasojën shënojnë lavdinë e heroizmi të shtetit të Skënderbeut. Rezistenca arbërore, në vitin 1455 duke ndjekur situatën politike rajonale, konkretisht luftën e hungarezëve kundër osmanëve, ndërmori aksionin luftarak për të çliruar Beratin dhe kështjellën e Sfetigradit. Në pushtimin e Beratit, Skënderbeut i duheshin artileri ngase kështjella ishte e ngritur lart.

Skënderbeu mirëpriti ushtrinë e Napolit si dhe mjetet luftarake të artilerisë sipas marrëveshjes së vitit 1453. Në korrik 1455, Skënderbeu me ushtrinë ku bënin pjesë edhe 2 mijë ushtarë napolitanë, e rrethoi Beratin. Në fillim ushtria e Skënderbeut arriti suksese, pushtoi qytetin e Beratit, e ngushtoi rrethimin e Kalasë së Beratit. Komandanti osman i kërkoi Skënderbeut 15 ditë që të tërhiqej dhe ta dorëzonte kalanë e Beratit. Në pritje të këtij armëpushimi, Skënderbeu mori aksion tjetër sulmues në kështjellën e Sfetigradit të cilën e kishin pushtuar osmanët.

Këtë armëpushim e shfrytëzoi ushtria osmane në Kalanë e Beratit së cilës i erdhën në ndihmë forca tjera ushtarake osmane nën udhëheqjen e Isak Bej Evernozit. Ardhjen e ushtrisë osmane e kishte mundësuar dezertimi i Mojsi Golemit, i cili ishte komandant i forcave kufitare, dhe i pakënaqur me forcimin e autoritetit të madh dhe pushtetit qeverisës të Skënderbeut, dezertoi në anën osmane dhe nuk e kishte penguar ushtrinë osmane për në Berat. Luftimet tani u vështirësuan për Skënderbeun. Ushtria arbërore pësoi dëme të rënda ushtarake. Kjo situatë e rëndë në kampin e Skënderbeut ndikoi edhe në keqësimin e situatës politike. Disa krerë të shquar feudalë të nxitur edhe nga Venedikut, duke menduar se tashmë rezistencës arbërore i ka ardhur fundi dhe nuk mund të qëndrojë më përballë stuhive të pandalshme osmane dhe pretendimeve permanente të Venedikut në dëm të qyteteve dhe porteve të rëndësishme të Arbërisë, filluan të kërkonin strehim tek shtetet tjera: Dukagjinët u prishën prapë me Skënderbeun dhe kaluan në anën e osmanëve, Mojsi Golemi, Hamza Kastrioti po ashtu kaluan në anën e osmanëve. Gjergj Arianiti kaloi në anën e venedikaseve.³³ Në vitin 1456, një ushtri e madhe osmane prej 15 mijë vetash, nën udhëheqjen e Mojsi Golemit, nga Selaniku depërtoi në Dibrën e Epërme. Beteja mes ushtrisë osmane dhe arbërore u zhvillua më 18-20 maj 1456 në Oranik dhe mbaroi në mënyrë katastrofale për ushtrinë osmane dhe vetë Mojsiun. Mojsiu i përbuzur nga Sulltani për disfatën

³² Po aty, 70.

³³ Noli, *Gjergj Kastrioti Skënderbeu 1405-1468*, 112.

pas dy muajve u kthye në Arbëri dhe i penduar thellë iu dorëzua Skënderbeut. Skënderbeu ia fali fajin dhe ia ktheu Mojsiut të gjitha privilegjet e përparme.³⁴

Viti 1457 është një ndër vitet më të rënda që shënohen në historinë e Skënderbeut. Vdekja e Janosh Hunadit në gusht 1456, e rëndoi peshën e rezistencës arbërore. Kalimi i Hamza Kastriotit në anën osmane e rëndoi peshën e rezistencës arbërore. Në korrik të vitit 1457, Sulltan Mehmeti II, nën drejtimin e Hamza Kastriotit dhe Isak bej Evrenozit dërgoi në Arbëri ushtri të madhe me 80 mijë veta. Ushtria e Skënderbeut numëronte 20 mijë vetë. Evernozi hyri në luginën e Matit e depërtoi ngadalë drejt Krujës. U zhvilluan ca beteja, dhe ushtria e Skënderbeut vazhdimisht kreu një varg veprimesh ushtarake dhe tërhiqej me shpejtësi. Qëllimi ishte për t'i bindur osmanët se ushtria e tij ishte shpartalluar. Skënderbeu shpërndaui pjesën kryesor të ushtrisë së tij. Kësisoj kampi ushtarak osman mendoi se ushtria arbërore është shpartalluar.

Kjo manovër duket se pati suksese, sepse edhe kapiteni venedikas i Durrësit, Marko Diedo, më 31 korrik 1457 e njofton Dogjin e Republikës së Venedikut se *“forti larti Skënderbe po bredh nëpër male për të shpëtuar kokën dhe u braktisë nga të gjithë krerët kryesorë të rrethit të vet, që shkuan të bashkohen me osmanët”*.³⁵ Një përshtypje të tillë fituan edhe komandantët osmanë, prandaj ushtria e tyre filloi të dëfrehej e shkujdesur. Skënderbeu duke shfrytëzuar momentin e volitshëm dha urdhër që të sulmohej kampi ushtarak osman, që gjendej i vendosur në fushën e Albulenës pranë Milotit. Ushtria e shpërndarë osmane nuk arriti të rregullohej. Osmanët lanë në fushën e betejës 20 mijë të vrarë e 1 500 të zënë robër. Midis tyre qe edhe Hamza Kastrioti, të cilin Skënderbeu e internoi në Itali.³⁶ Rëndësia e fitores së Albulenës për rezistencën arbërore ishte e madhe, si në planin e brendshëm ashtu edhe në atë ndërkombëtar. Fitorja në radhë të parë e forcoi unitetin e rezistencës arbërore, kurse në faktorin e jashtëm emri Arbëri ishte bërë i njohur dhe me shumë simpati në tërë Evropën. Vullnetarë të huaj nga vende të ndryshme erdhën në Shqipëri dhe hynë vullnetarë në radhët e ushtrisë arbërore. Skënderbeu pas vdekjes së Huniadit u bë figura kryesore evropiane e luftës kundër osmanëve. Kalorësi anglez shkruan në vitin 1457: *“Invazioni i Evropës është i sigurtë, sepse s'ka fuqi tjetër që mund ta bëjë këtë rezistencë po të bjerë kështjella arbërore”*.³⁷ Fitorja e forcave arbërore në betejën e

³⁴ Masar Kodra, “Rezistenca e dibranëve kundër turqve gjatë aksioneve luftarake të Skënderbeut”, *Simposium për Skënderbeun*, (Prishtinë, Instituti albanologjik, 1969), 142.

³⁵ *Historia e popullit shqiptar I*, (Prishtinë, 1967), 277.

³⁶ Hadri, *Gjergj Kastrioti-Skënderbeu dhe epoka e tij*, 94.

³⁷ *Historia e popullit shqiptar I*, 278.

Ujëbardhit (Albulenës), sikur po rikthente shpresat tek projektet papale të kryqëzatës. Papa Kalisti III me rastin e fitores në Ujëbardhë, më 23 dhjetor 1457, e emëroi Skënderbeun me dekret pontifikal “*Kapiten të përgjithshëm të Selisë së Shenjtë*” në luftë kundër osmanëve.³⁸

Pas kësaj fitoreje deri më 1462 në truallin e arbërve nuk pati përlëshje të rëndësishme midis ushtrisë arbërore dhe asaj osmane.³⁹ Në rrethanat e krijuara, në ngritjen e fuqisë ushtarake të Skënderbeut dhe sukseseve të mëdha në përballje luftarake me ushtrinë osmane, ajo ushtri e detyroi Sulltan Mehmetin II të bëjë marrëveshje armëpushimi paqe prej tri vjetësh. Gjatë këtij armëpushimi Skënderbeu i shkoi në ndihmë aleatit të tij, mbretit të Napolit Ferdinandit të birin e Alfonsit V, në luftën për ta ruajtur fronin mbretëror nga kryengritje e fuqishme e banorëve të Italisë së Jugut të cilët ishin bashkuar me princin francez Rene të Anzhuinëve që pretendonte fronin e mbretërisë së Napolit.⁴⁰

Një nga kundërshtarët e Ferdinandit, Xhovani Antonio Orsini, princi i Tarantos, i shkruan një letër Skënderbeut më 31 tetor 1460, me qëllim që Skënderbeu të hiqte dorë nga ekspedita në Itali. Në letër e rekomandon Skënderbeun se kalorësia e tij e lehtë është e pasuksesshme ndaj kalorësisë së rëndë italiane, dhe se nuk do ta ndryshonte fatin e Ferdinandit. Skënderbeu, në përgjigjen që i bëri princit të Tarantos, më 31 tetor 1460, ndër të tjera i tregon edhe arsyen e ekspeditës atje duke i kujtuar atij se Mbreti Alfonsi V ka bërë angazhime dhe luftëra të drejtpërdrejta kundër ushtrisë osmane që synonte të dilte në Itali. Skënderbeu ia kujton princit të Tarantos, se: *po të isha mundur unë, sigurisht Italia do ta kishte ndjerë dhe rrjedhimisht ai vend për të cilin ju thoni së është i juaj do të ishte i osmanëve*.⁴¹ Në këtë vështrim, Skënderbeu ia shpjegon se: *“më mirë të ndihmoj ky mbret se sa banorët kryengritës dhe anzhuinët që po pretendojnë me marrë fronin mbretëror të Napolit e të cilit nuk kishin dhënë asnjë kontribut në luftë kundër*

³⁸ Kristo Frashëri, *Gjergj Kastrioti Skënderbeu jeta dhe vepra*, (Tiranë, “Toena, 2002), 357.

³⁹ Hadri, *Gjergj Kastrioti-Skënderbeu dhe epoka e tij*, 94; *Gjergj Kastrioti-Skënderbeu dhe lufta shqiptaro-turke*, 77.

⁴⁰ Skënderbeu dhe mbreti anzhuin Alfonsi V i Mbretërisë së Napolit, më 26.03.1451, nënshkruan aleancën e përbashkët ushtarake e politike. Përmbajtja e marrëveshjes në paragrafin e katër ka karakter vasaliteti nga ana e Skënderbeut ndaj Alfonsit V. Mbi bazën e marrëveshjes, Skënderbeu iu përgjigj aleatit të vet, Mbretërisë së Napolit, me të cilën kishte realizuar disa bashkëpunime ushtarake siç ishte rasti me ardhjen e 2 mijë ushtarëve napolitanë në ndihmë të Skënderbeut me rastin e betejës së Beratit më 1456, si dhe me dërgimin nga ana e tyre material për artilleri të rëndë për ushtrinë e Skënderbeut. *Gjergj Kastrioti-Skënderbeu dhe lufta shqiptaro-turke*, 68.

⁴¹ Burime të zgjedhura për historinë e Shqipërisë, vëllimi II shek. VIII-XV, (Tiranë, 1962), f. 330.

osmanëve”.⁴² Më tej Skënderbeu në përgjigjen në letrën drejtuar princit të Tarantos, i cili kishte gjykuar se ushtria e Skënderbeut është e pa aftë në luftë në Itali, shkruan: *ka ndryshuar puna, e në qoftë së kronikat tona nuk gënjejnë, ne quhemi Epirot dhe duhet ta dini se në kohë të tjera, stërgjyshet tanë kanë kaluar në vendin tuaj dhe kanë bërë me romakët luftime të mëdha dhe e dimë se më të shumtën e herës u ndamë me nder se me turp (bëhet fjala për betejat e zhvilluar të mbretit Ilir Pirro në Itali në vitin 280)*”.⁴³

Në gusht të vitit 1461, Skënderbeu me një ushtri prej 2 500 vetash u nis për në Itali. Gjendja e mbretit Ferdinand ishte mjaft e rëndë, kryengritësit italianë kishin pushtuar e rrethuar kështjellat e rëndësishme të mbretit Ferdinand. Ushtria e Skënderbeu me aksion të suksesshme arrit që të sprapste kryengritësit në kështjellën Barleta. Skënderbeu me ushtrinë në fund të vitit 1461 arriti që të korrë suksese në kështjellën e Tranit në luftim kundër ushtrisë kryengritëse. Ishin këto fitore që i mundësuan Ferdinandit të mund kundërshtarët e vet. Sukseset ushtarake të ushtrisë së Skënderbeut, u bënë të njohura edhe në analet e kohës. Duka i Milanos, Aleksander Sforca, i shkruan Skënderbeut dhe e falënderon udhëheqësin arbëror për shërbimet e mëdha që ky i kishte bërë jo vetëm Mbretërisë së Napolit, po gjithë shteteve italiane duke ndihmuar për eliminimin e ndërhyrjes së dëmshme të Francës në Itali.⁴⁴ Skënderbeu u kthye në Arbëri më 1462, ku gjeti një gjendje jo fortë të qetë.⁴⁵ Gjatë këtij viti Sulltan Mehmeti II ndërmoi tri ekspedita. Por, ushtria e Skënderbeut u bëri ballë me betejat të zhvilluara në Luginën e Mokrës, në fushën e Pollogut dhe e treta në fund të shtatorit në Livad afër Ohrit.⁴⁶

Faza e tretë e Luftës çlirimtare arbërore në kohën e Skënderbeut

Ekspedita ushtarake osmane, thuhet tani të rëndomta për rezistencën shqiptare arritën kulmin e tyre në vitin 1465, ku u ndërmorën katër ekspedita të njëpasnjëshme të udhëhequr nga Ballaban Pasha, një nga ushtarakët më të dëgjuar të kohës të Perandorisë Osmane. Ushtria e Skënderbeut me sukses arriti që të përballet me betejën e zhvilluar në fushën e Vajkalit afër Bulqizës. Ushtria arbërore pati humbje të mëdha në anën e saj. Shumë ushtarë u zunë robër nga ana e osmanëve bashkë me ta edhe tetë komandantë të shquar të ushtrisë së Skënderbeut, si: Moisi Golemi, Vlladan Jurica, Muzaka i

⁴² Po aty.

⁴³ Po aty, 331.

⁴⁴ *Gjergj Kastrioti-Skënderbeu dhe lufta shqiptaro-turke*, 80.

⁴⁵ *Historia e popullit shqiptar I*, 280.

⁴⁶ Noli, *Gjergj Kastrioti Skënderbeu 1405-1468*, 125.

Angjëlinëve.⁴⁷ Në gusht të vitit 1465 në Arbëri hyri ushtria osmane në dy drejtime: njëri drejtim hyri nga Maqedonia nën komandën e Ballaban Pashës dhe drejtimi tjetër nga Gjirokastra nën drejtimin e Jakup Arnautit. Ushtria e Skënderbeut së pari e theu ushtrinë e Ballaban Pashës në fushën e Vajkalit, dhe pas disa ditësh po ashtu u mposht ushtria osmane tjetër në fushën e Kasharit, ku mbet i vrarë edhe Jakup Arnauti renegat dhe i biri i feudalit të shquar arbëror, Teodor Muzaka.⁴⁸

Sakrificat supreme e rezistencës shqiptare arrihet në vitin 1467 e cila ndaj ushtrisë shumë të madhe osmane, nën Kalanë e Krujës e mbrojti me suksese lirinë e vendit. Duke menduar se ishte momenti i volitshëm për ta shkatërruar rezistencën arbërore, Sulltan Mehmeti II vendosi të vinte vetë në Arbëri. Në qershor 1466, në krye të armatës së jeniçerëve dhe të ushtrive të Anadollit dhe të Rumelisë prej më se 150 mijë vetë, duke ardhur nga Manastri hyri në Arbëri.⁴⁹ Kronisti osman, Kemal Pashazade, për këtë ekspeditë thonë se këtë radhë *“fatihu kishte vendosur të shtypte me çdo kusht rezistencën arbërore”*.⁵⁰ Sulltani e ndau ushtrinë në dy pjesë: njëra e rrethoi kalanë e Krujës, ndërsa pjesa tjetër e ushtrisë osmane u vu në ndjekje të një pjese të ushtrisë së Skënderbeut, e cila rëndom rrinte jashtë mureve të kalas. Kronisti osman, Qemail Pashë Zadeja, shkruan: *“për shkak të dëmeve të mëdha që pësuan me arbit, ushtria osmane u tregu e tmerrshme dhe s’lanë bimë mbi tokë”*.⁵¹ Për ashpërsinë e osmanëve në këtë luftë tregon kronisti osman, Taurusun, i cili thotë: *me urdhër të Padishahut u vra cilido që u zu i gjallë, vendi u plaçkit tmerrësisht, gratë dhe fëmijët u morën robër”*.⁵² Popullata arbërore duke e ditur për rrezikun që iu kanosej nga ushtria osmane, kësaj radhe braktisën vendbanimet në fushat dhe lugina, duke u tërhequr në vende më të sigurta në thellësi të bjeshkëve të mëdha. Repartet osmane të stërvitura në luftimet e maleve, i ndoqën arbit deri në thellësi, por kudo ndeshën në rezistencë të vendosur. Kronisti osman, Pashazade, shkrua: *“luftëtari më i dobët i tyre është nga më trimat në fushën e luftës, dhe ndonëse ai ka një hark prej druri me disa shigjeta, prapëseprapë është më i fortë se hekuri”*.⁵³ Me gjithë luftime të ashpra, arbit heroikisht kudo i bënë rezistencë armikut. Kronisti osman, Tursuni, shkruan: *“arbit janë të lindur për të kundërshtuar*

⁴⁷ Gjergj Kastrioti-Skënderbeu dhe lufta shqiptaro-turke, 83.

⁴⁸ Po aty.

⁴⁹ Historia e popullit shqiptar I, 282.

⁵⁰ Lufta shqiptaro-turke në shekullin XV - burime osmane, Tiranë: Universiteti Shtetëror i Tiranës & Instituti i Historisë dhe Gjuhësisë, (1968), 192.

⁵¹ Po aty.

⁵² Po aty, 101.

⁵³ Burime osmane, 192.

e për t'u mos u bindur".⁵⁴ Kronisti bizantin, Kritobuli, njofton për qëndresën deri në vetëflijm të popullatës arbërore e cila nuk bënte pjesë në repartet ushtarake duke u hedhur poshtë në humnera dhe shkëmbinj të mëdhenj, por se në çfarëdo rrethane ata nuk pranonin të binin robër tek ushtria osmane.⁵⁵

Pjesa tjetër e ushtrisë osmane e rrethoi Krujën. Skënderbeu në Krujë kishte repartin ushtarak prej 4 mijë vetave nën komandën e Tanush Topisë, dhe vetë ai me një ushtri prej 3 mijë vetave qëndronte jashtë. Muret e Krujës u goditën fort nga artileria osmane. Skënderbeu si edhe më parë nga jashtë, me sulmet e tija të shpeshta u shkaktonte dëme të mëdha ushtrive të panumërta të osmanëve.⁵⁶ Për t'i siguruar një pikëmbështetje të sigurt ushtrisë osmane, Mehmeti II kishte rindërtuar qysh në korrik kalanë e vjetër të rrënuar të Valmit, të cilës ia vuri emrin Ilbasan (vend që sundon). Sulltan Mehmeti vetë për dy muaj me radhë e drejtoi operacionin e luftimeve në Krujë. Në muajin gusht Sulltan Mehmeti II u largu nga Kruja duke e lënë për udhëheqës të ushtrisë osmane Ballaban Pashën, më 80 mijë ushtarë të cilët e mbanin të rrethuar Krujën. Sulltan Mehmeti II duke u kthyer me ushtrinë e tij gjatë rrugës prej Elbasanit për në Dibër, ai rrethoi dhe e pushtoi qytezën e Çidhnës, ku ishin strehuar rreth 10 mijë gra, pleq e familje, në tentim për t'u fshehur nga ushtritë osmane, dhe në shenjë hakmarrje u vranë dhe u morën robër.⁵⁷ Ushtria osmane gjatë kohës së qëndrimit në Arbëri e kishte shkatërruar në mënyrë të pamëshirshme vendin, sa s'kishte mbetur, si thotë Qemal Pashë-Zadeja, "Ai (Padishau-Sulltan Mehmeti II) shkatërroi vendin rreth e rrotull, rrëmbeu bagëtinë e gjallë, theu çdo pemë dhe prishi arat e mbjella".⁵⁸

Gjendja në Arbëri ishte e rëndë, Skënderbeu nuk kishte as të holla, as municion, as ushqim të mjaftueshëm për të vazhduar luftën.⁵⁹ Kështu, Skënderbeu, iu drejtua aleatëve për ndihmë. Nëpër disa shtete dërgoi përfaqësuesit, djalin Gjonin e dërgoi në Venedik, kurse vetë ai shkoi në Romë të Papa Pali II për t'i bindur për nevojat e ndihmës. Në Romë, Skënderbeu arrit më 12 dhjetor 1466. Qyteti i Romës e priti në mënyrë madhështore, turmat e shumta njerëzisht të pabesueshme rendën për ta parë dhe për ta nderuar. Vetë Papa Pali II organizoi pritje madhështore që i kishte befasuar edhe ambasadorët e Milanit, të cilët nga përshtypjet e ditës së parë në Romë,

⁵⁴ *Burime osmane*, 102.

⁵⁵ Koço Bozhori, *Lufta shqiptaro-turke në shekullin XV - burime bizantine*, (Tiranë: Universiteti Shtetëror i Tiranës Instituti i Historisë dhe Gjuhësisë 1967), 85.

⁵⁶ *Historia e popullit shqiptar I*, 282.

⁵⁷ *Burime osmane*, 203

⁵⁸ *Burime osmane*, 205.

⁵⁹ Fan S. Noli, *Gjergj Kastrioti Skënderbeu 1405-1468*, (Tiranë: Shtëpia botuese "Naim Frashëri", 1967), 141.

shkruanin: Papa i kishte bërë nderime të mëdha duke nxjerrë për ta pritur të gjitha familjet e kardinalëve, familjen e vet, dhe shumë prelatëve dhe oborrtarëve të tjerë... *për nderim dhe shoqërim ishin ftuar të gjithë ne, ambasadorët*".⁶⁰

Më 24 dhjetor në natën e Krishtlindjes, Papa Pali II në mesin e gjithë klerit të lartë të Romës dhe personaliteteve tjera u ftua edhe Skënderbeu, me q'rast ai u nderua nga Papa me dhurata simbolike: një shpatë dhe kësule, si shenjë nderim për luftën e madhe duke e quajtur "Aleksandër të epirotëve".⁶¹ Megjithatë Skënderbeu nuk e mori ndihmën e duhur nga Selia e Shenjtë e Papës. Selia Papale ia akordoi ndihmën prej 5 mijë dukatesh Skënderbeut krejt në fund të qëndrimit të tij në Romë. Skënderbeu ishte i pakënaqur me ndihmat që u akordua nga Selia e Shenjtë. Pakënaqësinë e Skënderbeut e dëshmojnë raporti i ambasadorëve Lorenzo de Pasaro e Agostino de Rossi drejtuar dukës së Milanit më 24 janar 1467, ku Skënderbeu ishte shprehur qartë për mospërkrahjen e Selisë së Shenjtë duke thënë: "*nuk duhet luftuar kundër osmanëve, por kundër kishës*".⁶² Nga Roma Skënderbeu shkoi në Napoli te aleati për të kërkuar ndihmën e duhur. Edhe Napoli nuk i dha veçse ndihma të kufizuara: disa ushqime e municione dhe një mijë dukatë.⁶³ Në fillim të prillit 1467 Skënderbeu u kthye në Arbëri, dhe iu drejtua masave popullore për të bërë sakrificën e fundit supreme ndaj atdheut. Masat popullore si kurdoherë edhe tani iu përgjigjen thirrjes së udhëheqësit të tyre. Pasi organizoi ushtrinë së bashku me repartet ushtarake të Lekë Dukagjinit, shpartalloi ushtrinë osmane që mbante të rrethuar Krujën. Vetë udhëheqësi i ushtrisë osmane, Ballaban Pasha, mbeti i vrarë. Skënderbeu u përpoq dhe e rrethoi Elbasanin, por duke mos pasur artileri, nuk arriti që të shtinë në dorë.

Rezistencën arbërore në muret e Krujës, Sulltan Mehmeti II e konsideronte tani si problemin kryesor të qëllimit të politikës së tij, përgatitjen e ekspeditës ushtarake për në Itali. Në korrik të viti 1467, dërgoi në Arbëri një ekspeditë të madhe ushtarake për të rrethuar Krujën, qendrën e rezistencës arbërore. Gjatë rrugëtimit të ushtrisë osmane në Arbëri u ndesh në shumë vende me sulme nga radhët ushtarake arbërore si në Buzursheku (në luginën e Shkumbinit). Pre e sulmeve të ushtrisë osmane ishin edhe qyteti i Durrësit dhe ai i Shkodrës, ku ushtria osmane bëri plaçkitje e shkatërrime të mëdha.

⁶⁰ Oliver Jens Schmitt, *Skënderbeu*, (Tiranë: K&B 2008), 393.

⁶¹ Aurel Plasari, *Skënderbeu, një histori politike*, (Tiranë: Instituti i Studimeve Shqiptare "Gjergj Fishta, 2010)", 210.

⁶² Kristo Frashëri, *Skënderbeu dhe lufta shqiptaro-turke në shek. XV*, (Tiranë: Botimet "Toena", 2005), dok. 84.

⁶³ *Historia e popullit shqiptar I*, 284.

Ushtria e Skënderbeut u mbrojtë me heroizëm të lartë në Krujë, qendrën e rezistencës arbërore. Ushtria osmane nuk arriti që ta mposhtë rezistencën arbërore nën muret e Krujës.

Kritobuli, kronisti bizantin, shkruan: “*duke e parë se do të ishte e pamundur ta merrte me sulm me anën e armëve*”.⁶⁴ Sulltan Mehmeti II u largu turpshëm në gusht të vitit 1467, duke e lënë një pjesë të ushtrisë së tij që ta vazhdonte rrethimin e Krujës. Mosprezenca e Sulltan Mehmeti II ndikoi tek ushtria osmane e cila shumë shpejt u shpartallua. Rezistenca arbërore me suksese të madh arrin që të rezistojë në qytetin e Krujës. Megjithatë situata ekonomike dhe materiale në vend ishte keqësuar si pasojë e luftërave të gjata dhe shumë të mëdha të cilat kishin shpenzime të mëdha ekonomike. Ndihamat e premtuar dhe të pritura nga vendet aleate të Italisë qenë shumë të pakta. Tani në këtë kohë vetëm Venediku shfaqti interesim më të shtuar ndaj rezistencës arbërore, dhe kjo për shkak të frikës së saj për pushtimin e Vlorës dhe pjesës bregdetare arbërore që nuk ishte pushtuar ende nga osmanët. Me qëllim të riorganizimit të vendit, Skënderbeu në janar të viti 1468 thirri Kuvendin e Lezhës ku u bënë bashkë krerët feudalë arbërorë ndaj kërkesave që kërkonte koha. Në ndërkohë një ushtri osmane prej rreth 15 mijë vetash e ardhur nga Kosova sulmoi qytetin e Shkodrës. Ushtria arbërore korri sukses duke sprapsur ushtrinë osmane. Më 17 janar 1468, Skënderbeu i cili ishte i sëmurë, vdiq i mbuluar me një lavdi të përjetshme. Ai u varros në Katedralen e Shën Kollit.⁶⁵

Rezistenca çlirimtare e ndodhur në kohën e Skënderbeut, është periudha e cila me sukses u bëri ballë sulmeve të shumta e me kapacitete të mëdha ushtarake osmane të cilat u mundën përpara qëndresës heroike arbërore, rëndësinë e së cilën do ta ndjej edhe qytetërimi evropian në atë kohë. Platformën e rezistencës për liri të vendit Skënderbeu e hartoi në Kuvendin e Lezhës të vitit 1444. Mbi bazën e kësaj platforme ushtria arbërore e kohës së Skënderbeut luftoi pa u reshtur edhe kundër Venedikut, e cila synonte që ta merrte krejt bregdetin arbëror, dhe po ashtu cenonte në vazhdimësi luftën e rezistencës arbërore duke arrit që të vendos politikë përçarëse ndërmjet krerëve të shquar feudalë arbërorë. Skënderbeu në saje të kërkesave të domosdoshme për të riorganizua dhe për ta fuqizua rezistencën arbërore mori masa tjera centralizuese feudale, riorganizoi ushtrinë me ndërrime të pozitive ushtarake e administrative të udhëheqësve, duke shpërndarë prona feudale që shkonin në drejtim të forcimit të rezistencës si dhe duke i ndalur me forcë synimet separatiste të feudalët arbërorë që shfaqeshin të pakënaqur në

⁶⁴ Bozhori, *Lufta shqiptaro-turke në shekullin XV- burime bizantine*, 91.

⁶⁵ *Historia e popullit shqiptar I*, 284.

pikëpamjet e tyre anticentraliste të shtetit të Skënderbeut. Skënderbeu arriti që me rezistencë të madhe me luftëra të shumta ta bashkon tërë popullin për liri dhe mbrojtje të vendit. Në këto luftëra Skënderbeu u bë një ndër strategët ushtarak më të mëdhenj të kohës, strateg i shkëlqyeshëm me aftësi të rralla për t'u gjetur kurdoherë sipas rastit. Ai arriti me suksese të mbronte qytetin e Krujës në tri përpjekjet e ushtrisë osmane, e cila kishte ardhur më forca të shumta ushtarake e me armatim më të sofistikuar të kohës.

Në tërësi lufta arbërore nën udhëheqjen e Skënderbeut është luftë mbrojtëse. Skënderbeu nuk ndërmori luftëra ofensive, sepse një luftë e tillë ishte jashtë fuqive dhe mundësive të popullatës arbërore, e cila ekonomikisht përballej me rrethana të vështira si dhe në numër ushtarakisht ishte jo e madhe. Lufta e popullit arbëror në kohën e Skënderbeut ndonëse me rëndësi ndërkombëtare, pak ishte ndihmuar nga shtetet e huaja. Për luftën e popullit arbëror të kohës së Skënderbeut janë shkruar shumë vepra, janë bërë piktura të çmueshme në artin botëror dhe përderisa në botë të ketë përjetime dhe raporte jo të barabarta midis shtetit të madh dhe të vogël, lufta e popullit arbëror në epokën e Skënderbeut do të jetë shembull për popujt që luftojnë për liri dhe pavarësi.